



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

**Funksionimi i sistemit të Grantit të
Performancës Komunale dhe menaxhimi
i projekteve të financuara nga Donatorët
për vitin 2021**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000¹) si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë², efikasitetit³ dhe efektivitetit⁴ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të performancës “Funksionimi i sistemit të Grantit të Performancës Komunale dhe menaxhimi i projekteve të financuara nga Donatorët për vitin 2021” në konsultim me Ndhimës Auditoren e Përgjithshme, Myrvete Gashi, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Fatlinda Ramosaj, Drejtor i Departamentit të Auditimit

Laureta Matoshi Pozhegu, Udhëheqëse e Ekipit

Vjosa Zeqiraj, Anëtare e Ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa: Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjia Arbëria, Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011

<http://zka-rks.org>

1. Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike.

2. Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

3. Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

4. Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave.....	4
Përmbledhje e përgjithshme	5
1. Hyrje.....	7
2. Objektiva e auditimit.....	9
3. Gjetjet e auditimit.....	10
3.1 Funksionimi i sistemit të Grantit të Performancës Komunale	10
3.2 Menaxhimi dhe realizimi i projekteve për vitin 2021 ishte përcjellë me disa mangësi	16
3.3 Dobësi në menaxhimin e kontratave	21
3.4 Rezultatet e synuara dhe përfshirja e grupeve të marginalizuara në projektet e financuara nga GPK.....	26
4 Konkluzionet	35
5 Rekomandimet	37
Shtojca I Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	39
Motivi i auditimit	39
Kriteret e auditimit	42
Fushëveprimi i auditimit	44
Metodologjia e auditimit.....	45
Shtojcat II Komunitet e audituara për vitin 2021 dhe buxheti i ndarë për projekt nga secili fond.....	46
Shtojca III Anketa me qytetarët.....	47
Shtojca IV Pyetësori për komunitet përfitues 2021.....	48
Shtojca V Letër Konfirmimet dhe komentet.....	50

Lista e shkurtesave

AK	Autoritet Kontraktues
DEMOS	Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave
DONATORËT	SDC, SIDA dhe NORAD
HSIK	Fondacion Zviceran në Kosovë HELVETAS
FS	Fondi Stimulues
GPK	Granti i Performancës Komunale
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
NORAD	Agjencia Norvegjeze për Bashkëpunim Zhvillimor
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i Auditimit “Funksionimi i sistemit të Grantit të Performancës Komunale dhe menaxhimi i projekteve të financuara nga Donatorët për vitin 2021” është realizuar në bazë të marrëveshjes në mes Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (përmes Projektit për Decentralizim dhe Përkrahje Komunale si zbatues). Qëllimi i këtij auditimi është që të vlerësojë funksionimin e sistemit të Grantit të Performancës Komunale nga viti 2018 deri në vitin 2021, si dhe të vlerësojë nëse menaxhimi dhe shpenzimet për projektet kapitale të financuara nga Donatorët për vitin fiskal 2021 është bërë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe ka arritur rezultatet e synuara.

Auditimi ka konkluduar se funksionimi i Grantit të Performancës Komunale i ndarë në dy qasje (dy burime të financimit) ka rezultuar me mangësi të cilat duhet të ju kushtohet vëmendje. Mangësitë kryesore të identifikuara janë: mjetet e ndara nga MAPL kërkojnë miratim shtesë, regjistrimi i dyfishtë i projektit si investim në vijim, kthimi i mjeteve si suficit dhe mungesa e kriterëve për caktimin se cila komunë nga cili burim do të përfitoj. Aktivitetet e prokurimit (zhvillohen nga komunat përfituese të grantit) për projektet e financuara nga Donatorët gjatë vitit 2021 ishin përcjellë me dobësi të ndryshme duke filluar nga mos përfshirja e projekteve në plan të prokurimit, ndarja e tenderëve në LOT-e e cila ka rezultuar me çmime më të larta, mos konfiskim i sigurisë së tenderit, nënshkrimi i kontratave pa caktuar vend punimin paraprakisht dhe dobësi të ndryshme në menaxhimin e kontratave. Më tutje, edhe pse rezultatet e synuara për projektet e realizuara janë arritur, komunat nuk kanë dëshmuar mjaftueshëm se kanë integruar grupet e marginalizuara në këto nisma, përveç në politika lehtësuese e strategji të komunave.

Sistemi i Grantit të Performancës Komunale i financiar nga dy burime është përcjellë me disa sfida. Sfidat kryesore ishin kthimi i mjeteve në fund vit dhe vonesat e shkaktuara nga alokimi i mjeteve nga financuesit e skemës kanë rezultuar me obligime të bartura për vitin vijues për komuna, projekte kapitale⁵ të pa regjistruara në Programin e Investimeve Publike, dhe vonesa e mos përfundim të projekteve të nënshkruara me Memorandumet e Mirëkuptimit me komuna.

Projektet e financuara nga Donatorët gjatë vitit 2021 nuk kanë arritur të përfundohen të gjitha ndërsa në një rast projekti do të mund të kryhej më lirë sikur procedura mos të ishte ndarë në LOT-e. Mungesa e projekteve ekzekutive, mos propozimi i termave të referencës dhe përpilimi i paramasave jo sipas matjeve në terren janë çështje që duhet të trajtohen nga komunat, pasi kanë rezultuar me nënshkrime të kontratave pa pasur vend punimin e planifikuar për investim, kontrata shtesë dhe shkëputje të kontratave.

5. Në Programin e Investimeve Publike nuk përfshihen projektet nga GPK

Ndarja në LOT-e e procesit të prokurimit edhe pse ishte në përputhje me legjislacionin në fuqi, i ka kushtuar Komunës së Drenasit 106,546 euro apo 27% më shumë se sa do t'i kushtonte sikur tenderi mos të ishte në LOT-e e rrjedhimisht operatorët ekonomik nuk do të mund të ofertonin me çmime të ndryshme për pozicione të njëjta. Mos konfiskimi i sigurisë së tenderit, u lejon operatorëve ekonomik të vazhdojnë të jenë të papërgjegjshëm gjatë ofrimit të dokumentacionit edhe në të ardhmen

Menaxhimi i zbatimit të kontratave në disa raste ka rezultuar joefikas. Dobësitë e evidentuara kanë të bëjnë me: ndryshim të kontratës pa aprovim paraprak nga Zyrtari Kryesor Administrativ, zgjatje e paarsyetuar e afatit për përfundim të projektit dhe ditare të punës të pa nënshkruar nga të gjithë zyrtarët përgjegjës.

Nga 185 projekte të financuara nga Granti i Performancës Komunale për vitet 2018-2021, prej tyre 165 janë përfunduar, dhjetë prej tyre janë në proces, grantet për tri projekte nuk janë shfrytëzuar, pesë kanë dështuar të realizohen nga komuna dhe vetëm dy projekte nuk janë përfunduar, e për të cilat është dashur të kthehen mjetet tek Donatorët.

Arritja e plotë e rezultateve të synuara dhe përfshirja e grupeve të marginalizuara në projektet e granteve të performancës komunale ende kërkojnë vëmendje nga komunat. Këto projekte edhe pse kanë arritur indirekt të përfshijnë të gjithë qytetarët, vetëm 10% nga 185 projektet e financuara nga Donatorët janë të dedikuara direkt për grupet e marginalizuara. Megjithatë, komunat kanë realizuar edhe projekte të dedikuara posaçërisht për këto grupe me fonde vetanake.

Me qëllim të analizimit të qasjeve për shpërndarjen e fondeve, përmirësimin e menaxhimit të projekteve për investimet e financuara nga Donatorët në vitin 2021, përfshirë edhe përmirësimin e menaxhimit të kontratave, janë dhënë disa rekomandime për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, DEMOS/Helvetas si zbatues i projektit dhe komunat përfutuese të këtij granti të cilat ishin pjesë e këtij auditimi për vitin 2021. Lista e rekomandimeve është paraqitur në kapitullin e pestë të këtij raporti.

Përgjigjja e palëve të përfshira në auditim

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe shtatë nga nëntë komunat e audituara janë pajtuar me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit. Letër konfirmimet për pranimin e gjetjeve dhe rekomandimeve për Komunat Lipjan, Vushtrri, Skenderaj, Pejë, Prizren, Mitrovicë e Jugut dhe Shtërpçë mund t'i gjeni në shtojcën V. Komentet e Komunës së Drenasit bashkë me pikëpamjet e Zyrës Kombëtare të Auditimit mund t'i gjeni poashtu në këtë shtojcë. Ndërsa ne nuk kemi pranuar përgjigje nga Komuna e Leposaviqit.

Inkurajojmë institucionet e përfshira në këtë auditim që të bëjnë të gjitha përpjekjet për të adresuar rekomandimet e dhëna.

1. Hyrje

Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave (DEMOS) fillimisht është i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, i cili ka kontraktuar Fondacionin Zviceran HELVETAS Swiss Intercooperation (HSIK) për zbatimin e këtij programi. Kjo nismë ka filluar nga viti 2010 ku është nënshkruar Marrëveshja bazë (Kornizë) ndërmjet Këshillit Federal të Zvicrës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) për bashkëpunim financiar, teknik dhe ndihmë humanitare. Si vazhdim i forcimit të bashkëpunimit ndërmjet dy qeverive duke u bazuar në Marrëveshjen Kornizë u nënshkrua edhe një marrëveshje në nëntor të vitit 2014⁶. Kjo Marrëveshje u nënshkrua në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfaqësuar nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal (tutje MAPL) dhe Qeverisë së Zvicrës, e përfaqësuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (tutje SDC).


Mjetet e planifikuara për Grantin e Performancës Komunale nga viti 2018 deri në vitin 2021 ishin rreth 14 milionë euro dhe janë financuar 185 projekte në komunat e Republikës së Kosovës. Në vitin 2021 nga 38 komuna të Kosovës, 21 prej tyre i kanë përmbushur kushtet minimale për t'u kualifikuar dhe për të përfituar nga ky grant. Shuma e përgjithshme e disponueshme për vitin 2021 ishte rreth 4.35 milionë euro.

Gjatë viteve 2018 deri 2021 për menaxhimin e Grantit të Performancës Komunale janë përdorur dy qasje të ndryshme. Grantet për financim të komunave janë ndarë në dy grupe të rastësishme: një grup ka përfituar nga fondet e donatorëve, kurse grupi tjetër nga fondet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Fondet e pashpenzuara për komunat që kanë përfituar nga fondet e donatorëve gjatë viteve 2018 dhe 2019 janë bartur tek komuna për vitin vijues, kurse fondet e pashpenzuara nga fondi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal janë kthyer si suficit në buxhetin e Republikës së Kosovës. Mirëpo, gjatë viteve 2020 dhe 2021 edhe fondet e pashpenzuara nga pjesa e donatorëve është kërkuar që të kthehen.

Për verifikimin e përparësive dhe mangësive sa i përket funksionimit të sistemit dhe menaxhimit të projekteve për vitin 2021 ne kemi audituar nëntë komuna. Në mostrim janë përfshirë tri natyrat e proceseve: fondet e shpenzuara për projektet e caktuara, fondet e pashpenzuara dhe fondet e kthyer. Tek Komunitat Drenas, Lipjan, Vushtrri dhe Skenderaj janë audituar menaxhimi i gjashtë projekteve në vlerë prej 892,794 euro. Komunitat Mitrovicë e Jugut, Leposaviq dhe Shtërpçë janë audituar për të kuptuar arsyen e mos shpenzimit të fondeve të pranuar në vlerë prej 391,884 euro ndërsa Komunitat Prizren dhe Pejë janë audituar për procedurën e kthimit të fondeve në vlerë prej 159,716 euro. Në total vlera e audituar është 1,444,394 euro apo 33% e shumës së përgjithshme të alokuar nga Donatorët për vitin 2021 apo 71% e vlerës së këtij granti të ndarë për komunat e audituara.

6. Marrëveshja për Decentralizim dhe mbështetje komunale (DEMOS/Helvetas), Faza I

Grafiku 1. Procesi i bashkëfinancimit të projekteve sipas burimeve të financimit



Përmes këtij projekti synohet mbështetja për Kosovën në procesin e saj të tranzicionit drejt një shteti demokratik dhe të decentralizuar, ku komunitet ushtrojnë qeverisje gjithëpërfshirëse shoqërore dhe të ofrojnë shërbime efektive duke iu përgjigjur prioritetëve dhe nevojave të qytetarëve.

Qëllimi i përgjithshëm i Grantit të Performancës Komunale (tutje GPK) është nxitja e komunave për të përmirësuar proceset e qeverisjes, të cilat së bashku me kornizën e politikave të përmirësuara do të çojnë në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët. Duke zhvilluar konkurrencën në mes të komunave, GPK-ja ka për qëllim të nxis ndryshime pozitive në sjelljen e komunave për përmirësimin e qeverisjes demokratike, menaxhimin e komunës dhe ofrimin e shërbimeve.

2. Objektiva e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është që të vlerësojë funksionimin e sistemit të Grantit të Performancës Komunale përgjatë viteve 2018-2021. Po ashtu, do të vlerësojmë nëse menaxhimi dhe efektiviteti i projekteve të financuara nga Donatorët për vitin fiskal 2021 është bërë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe ka arritur rezultatet e synuara.

Ky auditim synon të ofrojë rekomandime relevante për komunat e audituara, MAPL dhe DEMOS/Helvetas si zbatues i projektit për Donatorët me qëllim të menaxhimit më të mirë të projekteve kapitale të Grantit të Performancës Komunale, për të përmirësuar qasjen e tyre në raport me donacionet dhe mënyrën e investimeve të tyre.

Për të i'u përgjigjur objektivit të auditimit ne kemi parashtruar pyetjet auditimit si në vijim:

- I. Si ka funksionuar sistemi i Grantit të Performancës Komunale për vitet 2018-2021?
- II. Sa kanë arritur përfituesit e granteve për vitin 2021 të menaxhojnë projektet në mënyrën e duhur dhe a kanë siguruar transparencë për shpenzimin e këtyre fondeve?
- III. A i kanë arritur rezultatet e synuara projektet e financuara nga Donatorët?

Ky auditim kishte fushëveprim funksionimin e sistemit të shpërndarjes së granteve përgjatë viteve 2018-2021 (Donatorë dhe MAPL) përfshirë edhe mënyrën e rrjedhjes së parasë, verifikimin e listave të projekteve dhe gjendjen e vitit 2021. Për vitin 2021 janë audituar gjashtë projekte në komunat (Drenas, Vushtrri, Skenderaj dhe Lipjan), grantet e pashfrytëzuara në komunat (Mitrovicë e Jugut, Leposaviq dhe Shtërpçë), kthimi i mjeteve në komunat (Prizren dhe Pejë). Vlera e audituar ishte 1,444,394 euro apo 33% e shumës së përgjithshme të alokuar nga Donatorët për vitin 2021 apo 71% e grantit për komunat e audituara.

Metodologjia e detajuar e auditimit e aplikuar gjatë këtij auditimi, kriteret e auditimit dhe fushëveprimi i auditimit janë paraqitur në Shtojcën I.

3. Gjetjet e auditimit

Në këtë kapitull janë paraqitur gjetjet e auditimit të cilat paraqesin aktivitetet e palëve përgjegjëse për t'u siguruar se shpenzimi dhe menaxhimi i projekteve kapitale të financuara nga Granti i Performancës Komunale është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe se këto projekte kanë arritur rezultatet e synuara.

Rezultatet audituese janë strukturuar në tre pjesë të ndërlidhura me pyetjet e auditimit: pjesa e parë mbulon funksionimin e sistemit të GPK-së, pjesa e dytë mbulon menaxhimin e projekteve sipas kërkesave të marrëveshjes, zhvillimin e procedurave të prokurimit; dhe menaxhimit të kontratës dhe pranimi të punëve/mallit; ndërsa, pjesa e tretë prezanton pikëpamjet për përfitimin e qytetarëve nga projektet e realizuara dhe përfshirja e grupeve të margjinalizuara në këto projekte.

3.1 Funksionimi i sistemit të Grantit të Performancës Komunale

GPK është një grant nga i cili komunat përfitojnë mjete financiare duke treguar performancë në disa fusha të përzgjedhura. Kushtet minimale që komunat duhet të plotësojnë për t'u kualifikuar si përfituese të GPK-së janë: administrim i shëndoshë financiar⁷, opinionin e auditimit duhet të jetë së paku i pamodifikuar me theksim të çështjes dhe shpenzimet për investime kapitale duhet të jenë 75% ose më tepër e buxhetit për këtë kategori. GPK-ja do të bashkë-financohet nga QRK-ja dhe SDC-ja, Suedia dhe Norvegjia.

Pasi GPK përdoret për financimin e projekteve kapitale, planifikimi buxhetor është i rëndësishëm për nga vlera dhe qëllimi. Për vitet 2018 deri 2021, për këtë grant u planifikuan të ndahen rreth 14 milionë euro. Deri në vitin 2019 financues të këtij granti ishin SDC dhe MAPL, ndërsa në vitin 2019 u rishikua Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK), dhe u krijua një grant i vetëm për stimulimin e komunave që të përmirësojnë performancën në fushat e qeverisjes lokale demokratike, menaxhimin komunal dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, ku financimit iu bashkua edhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA) si dhe Agjencia Norvegjeze për Bashkëpunim Zhvillimor (NORAD).

7. Komunat duhet të kenë raportuar në të gjithë treguesit e SMPK; Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për t'i rishikuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga organet mbikëqyrëse; Komunat duhet të kenë nënshkruar marrëveshjen tripalëshe të pjesëmarrjes (komuna, MAPL-ja dhe HELVETAS Swiss Intercooperation)

Tabela 1. Fondet e ndara për financimin e projekteve nga GPK për vitet 2018-2021

MAPL	2018	2019	2020	2021
Fonde të planifikuara sipas Ligjit të Buxhetit për GPK	453,649	2,450,000 ⁸	2,500,000	1,500,000
Fonde të planifikuara sipas rregullave të GPK	453,649	950,000	2,500,000	1,500,000
Donatorët				
Fonde të planifikuara sipas rregullave të GPK	1,796,351	1,300,000	2,400,000	2,850,000
Fonde të planifikuara pas shtimit të donatorëve tjerë	1,796,351	1,805,858 ⁹	2,400,000	2,850,000
Totali i fondeve të planifikuara për projekte të GPK	2,250,000	2,755,858	4,900,000	4,350,000

8. Bashkimi i dy skemave ai i Fondit Stimulues (FS) dhe Granti i Performancës (GP) në një program në Ligjin e Buxhetit për vitin 2019

9. Marrëveshja e Grantit ndërmjet Ndërkombëtare Suedeze Agjencia për Bashkëpunim Zhvillimor, Sida dhe Fondacionit HELVETAS përmes DEMOS II

Tabela 2. Shuma totale e shpenzuar sipas viteve për projektet e financuara nga GPK

	2018	2019	2020	2021
Nr. i komunave përfituese	24	30¹⁰	23	21
Vlera e shpenzuar - MAPL	453,649	2,258,912 ¹¹	2,500,000	1,500,000
Vlera e shpenzuar – Donatorët	1,796,351	1,805,858	2,400,230	2,850,808
TOTAL	2,250,000	4,064,770	4,900,230	4,350,808

Si iniciativë e re për Kosovën, GPK ka pasur synim stimulimin e performancës komunale dhe riorganizimin e financimit të aktiviteteve në nivel lokal nga ministritë e linjës si dhe mbështetjen e koordinimit të mëtejshëm të donatorëve. GPK me sistemin e krijuar ka fituar një reputacion të mirë për objektivitet dhe integritet. Pavarësisht vlerës jo shumë të madhe të granteve, komunat janë të stimuluar për të përmirësuar performancën e tyre. Imazhi dhe renditja e komunave është po aq e rëndësishme sa edhe nxitja financiare¹².

Mirëpo, përkundër të gjitha përparësive që GPK-ja ka për stimulimin financiar dhe të performancës duke u bazuar edhe te pikë vështrimi i DEMOS-it/Helvetas, MAPL-së dhe nëntë komunave të audituara është se, realizimi i projekteve ka pasur edhe vështirësi dhe mangësi operationale.


Kështu që, përkundër mangësive të identifikuara, vërehet që GPK ka pasur ndikim pozitiv në përmirësimin e gjendjes së komunave përfituese. Këtë konstatim e mbështesin edhe raportimet e DEMOS/Helvetas, MAPL dhe komunave përfituese, siç mund të shihet në grafikun në vijim.

10. Prej tyre 19 komuna janë financuar sipas rregullave të GPK-së dhe 11 janë financuar edhe nga FS

11. Mjete të dedikuara për GPK-në janë 950,000€

12. End Phase Report II, DEMOS/Helvetas


Grafiku 2. Përparësitë dhe mangësitë nga funksionimi i GPK-së 2018-2021



Edhe pse financimi GPK-së ka shumë përparësi, ndarja e fondeve nga dy burime të financimit dhe menaxhimi jo i mirë i kohës nga komunat përfituese si rezultat edhe i shpërndarjes së vonshme të granteve, kanë rezultuar me ngecje në realizimin e objektivave të GPK-së. Po ashtu, mos zyrtarizimi i marrëveshjes në mes të MAPL-së dhe donatorët ka përfunduar me shfrytëzim të një pjese të fondeve për skemën e FS-së.

Në vijim kemi pasqyruar funksionimin e sistemit të GPK-së bashkë me disa nga mangësitë e identifikuara

Grafiku 3. Sistemi i GPK-së¹³



13. Raportimi nga MAPL, Donatorët dhe konfirmimi nga faza e ekzekutimit tek Komunat e audituara për vitin 2021 (9 komuna)

Mangësitë e lartcekura janë si rezultat i dallimeve sa i përket menaxhimit të GPK-së, qasjeve të ndryshme të trajtimit të fondeve dhe menaxhimit jo të mirë të kohës nisur nga shpërndarja e fondeve deri tek përfundimi i vitit fiskal.

Si rrjedhojë, e mos zyrtarizimit të marrëveshjes në mes të Qeverisë së Kosovës (përfaqësuar nga MAPL) dhe Donatorët ka rezultuar me disa mangësi në vete, siç janë:

- Marrëveshje të ndara të secilit donatorë dhe mos ndarje e detyrave dhe obligimeve për secilën palë në një dokument zyrtarë;
- Fondet shtesë nga donatorët jo të zyrtarizuara me amandamentime (anekse), por me marrëveshje individuale; dhe
- Bashkimi i Fondit Stimulues (FS)¹⁴ i MAPL-së me Fondin e GPK-së në një program të titulluar “Bashkëfinancimi me donatorë për skemën e granteve të bazuar në performancën komunale” përmes Letër konfirmimit nga MAPL dhe DEMOS/Helvetas.

Nga rezultatet e lartcekura, mund të vijmë në përfundim që GPK si skemë e rëndësishme e përkrahjes për reformim dhe zhvillim në nivel komunal, ka ende vend për përmirësim. Mangësitë e evidentuara janë si pasojë e mos zyrtarizimit të marrëveshjes mes Qeverisë së Kosovës dhe Donatorëve dhe si pasojë e ndryshimeve në qasje për menaxhimin dhe trajtimin e fondeve.

Ndryshimi i kriterëve në rregullat e GPK-së për kthim të mjeteve në vitin 2020 dhe 2021, ka bërë që komunat përfituese të bartin obligimet nga kontratat e nënshkruara për realizim të projekteve rrjedhimisht që projekte tjera të planifikuara jashtë GPK të mbesin të parealizuar. Ndërsa mos zyrtarizimi i marrëveshjes me të gjitha palët e përfshira, ka rezultuar me dokumente dhe komunikime individuale¹⁵ të cilat shkaktojnë pasiguri se qëllimi i GPK-së është arritur.

14. Në Ligjin e Buxhetit 2019 ndarja buxhetore tek MAPL ka përfshi Fondin Stimulues i MAPL- së i bashk me Fondin e GPK-së (950,000€) tek projekti “Bashkëfinancimi me donatorë për skemën e granteve të bazuar në përfundancën komunale” bazuar në Letër konfirmimit të dt. 24.06.2019 në mes MAPL-së dhe DEMOS/Helvetas.

15. Konfirmime zyrtare të ndara nga secili financues për secilin ndryshim në marrëveshje në mënyrë individuale

3.2 Menaxhimi dhe realizimi i projekteve për vitin 2021 ishte përcjellë me disa mangësi

Për shpenzimin e GPK-së, zbatohen rregullat ekzistuese të qeverisë të cilat zbatohen për investimet kapitale në kuadër të Grantit të përgjithshëm, për planifikim të Grantit, raportim dhe llogaridhënie. Komunitat përdorin procedurat vendore të tenderimit, kontraktimit, menaxhimit të kontratës dhe pranimet teknik. Komunitat mund të përdorin Grantin për investime kapitale sipas prioriteteve dhe nevojave të tyre, në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

Megjithatë, ky dizajn nuk është në përdorim për të gjitha fondet e GPK. Aktualisht, fondet e donatorëve menaxhohen ndryshe nga fondet e MAPL-së. Donatorët transferojnë fondet në komunitat përfituese përmes DEMOS/Helvetas, ndërsa MAPL i mban fondet e komunitave përfituese në buxhetin e saj dhe i paguan operatorët ekonomik pas përfundimit të punëve në komunitat përfituese. Fondet e GPK-së që menaxhohen nga MAPL nuk transferohen drejtpërdrejt në komuna dhe fondet e pashpenzuara në fund vit nuk mund të përdoren nga komuna përfituese në vitin fiskal vijues.

GPK nga viti 2018 deri në vitin 2021 ka financuar 185 projekte, mirëpo jo të gjitha kanë përfunduar dhe kanë rezultuar me sukses. Siç mund të shihen në tabelën më poshtë ka procese të cilat nuk kanë përfunduar, grantet nuk janë shfrytëzuar dhe kanë dështuar si pasojë e mangësive të paraqitura në kapitujt 3.1 dhe 3.2 të këtij raporti.

Tabela 3. Statusi i projekteve të financuara nga GPK për vitet 2018-2021

Fondi	Projektet e përfunduara	Projektet e papërfunduara	Grantet e pashfrytëzuara	Në proces	Projekt i dështuar nga komuna
Donatorët	121	2 ¹⁶	3 ¹⁷	2 ¹⁸	2 ¹⁹
MAPL - GPK	44	-	-	8	3
Total	165	2	3	10	5

16. Komuna Prizren - projekti 'Vendosja e kamerave të sigurisë në Prizren' vlera 140,000 euro dhe 'Pajisje medicinale' vlera 966 euro.

17. Komuna Mitrovica e Jugut projekti 'Ndërtimi i Urës te Liqeni Artificial vlera e projektit: 485.000 euro, Komuna Shtërpçë me projektin 'Ndërtimi i rrugëve lokale në Shtërpçë, në vendin e quajtur "Rrethoja" vlera 3,449 euro dhe Komuna Leposaviq projekti 'Rindërtimi i sheshit në qendër të Leposaviqit - Faza I vlera e tij 64,362 euro.

18. Komuna Drenas projekti 'Rehabilitimi dhe rindërtimi i rrugëve të asfaltuara në Drenas' vlera 250,000 euro dhe projekti 'Rehabilitimi dhe rikonstruksioni i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Drenasit' vlera 150,000 euro


19. Komuna Skenderaj projekti 'Shijojeni qytetin në këmbë në rrugën Ilaz Kodra në Skenderaj' vlera 50,000 euro dhe projekti 'Ndërtimi i çerdhes - Faza II' 50,000 euro.

Planifikimi dhe ekzekutimi i prokurimeve

Planifikimi i prokurimit është dokument me shkrim i cili tregon mallrat dhe punët e shërbimet të cilat do të prokurohen gjatë vitit fiskal. Planifikimi i prokurimit do të identifikoj në detaje të mjaftueshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që AK parasheh të prokuroj gjatë vitit të ardhshëm fiskal. Një planifikim i mirë është kur departamenti i prokurimit bashkëpunon ngushtë me njësitë kërkuuese, me departamentin e financave dhe departamenteve tjera relevante.

Procedura të prokurimit sipas planit nga Komunitat Drenas, Lipjan, Vushtrri e Skenderaj për vitin 2021 ishin afër 15 milion euro ndërsa kontrata të nënshkruara ishin afër 22 milion euro, pra ishin afër 50% më shumë totali i kontratave të planifikuara. Në grafikun në vijim kemi paraqitur komunitat që nuk kishin arritur të bëjnë një planifikim të mirë të prokurimit për vitin 2021. Janë gjetur dallime të dukshme nga 26% deri në 71% mes planit dhe realizimit të aktiviteteve të prokurimit. Këto dallime janë gjetur nga krahasimi i vlerave totale të planifikuara me plan të prokurimit dhe vlerës totale të raportit të kontratave të nënshkruara për vitin 2021.

Grafiku 4 Dallimi mes plani të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratave



Shkak kryesor që realizimi është më i lartë se plani i prokurimit në vitin 2021, është se në plan të prokurimit nuk janë përfshirë bashkëfinancimet me organizatat e huaja dhe Ministrinë përkatëse. Si rrjedhojë, nuk janë të përfshira as aktivitetet e prokurimit të inicuar në vitet 2019 dhe 2020²⁰ dhe projektet e pa planifikuara²¹, ku të gjitha këto kanë bërë që të kemi mos planifikim të duhur. Diferenca mes planit dhe realizimit të tij tregon për një planifikim jo të saktë.

20. Aktivitetet e prokurimit me ankesa në OSHP dhe mostrajtimi i tyre me kohë

21. Projektet e audituara në Komunitat Lipjan, Vushtrri e Skenderaj nuk kanë qenë të planifikuara

Mangësi në iniciimin e kërkesave për prokurim

Njësia e kërkesës e cila është iniciuese e kërkesës për prokurim, për secilin aktivitet të prokurimit ka përgjegjësinë të përgatitë/propozon specifikime teknike (bashkë me projektin kryesor), termat e referencës dhe paramasën dhe parallogarinë.

Për projektet e realizuara gjatë vitit 2021, ne kemi hasur inicime të kërkesave për prokurim me informata të mangëta, specifikime të përgjithësuara dhe pa terma të referencave të përpiluara/propozuara.

Komuna Drenas, gjegjësisht Departamenti i Infrastrukturës Publike si iniciues i kërkesës për prokurimin e projektit 'Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve në Komunën e Drenasit për tre LOT-et' në kërkesën për iniciim kishte vendosur specifikime të përgjithësuara, pa projekt kryesor për ekzekutim të kontratës dhe paramasa dhe parallogaria për secilin LOT ishte homogjen me sasi e specifika. Po ashtu nuk ishte specifikuar vendndodhja se ku do ndërtohej rrjeti i kanalizimit.

Komuna Lipjan, gjegjësisht Departamenti i Shërbimeve publike si iniciues i kërkesës për prokurimin e projektit 'Ndriçimi në Ribar të Madh dhe Zllakuqan' dhe te projekti 'Ndriçimi në Kraishtë', në kërkesën për iniciim kishte vendosur paramasën, parallogarinë dhe specifikat teknike të përgjithësuara si dhe mungonin termat e referencës.

Komuna Vushtrri, gjegjësisht Drejtoria për Shërbime Publike kërkesën për iniciimin e prokurimit të projektit 'Ndërtimi i trotuarit në fshatin Stanovc i Epërm' e kishte bërë vetëm me përpilimin e paramasës dhe parallogarisë, pa specifikime teknike të detajuara, pa projekt kryesor dhe pa terma të referencës;

Komuna Skenderaj, gjegjësisht Departamenti i Urbanizmit kishte bërë kërkesën për iniciimin e prokurimit për projektet – 'Shijoni qytetin në këmbë në rrugën Ilaz Kodra' dhe 'Ndërtimi i një kopshti - Faza II' me specifika teknike të përgjithësuara, pa terma të referencës ndërsa paramasa dhe parallogaria nuk përkonin me gjendjen në terren²².

Këto kanë ndodhur si pasojë e moskujdesit nga ana e njësive kërkuese dhe praktikave të zyrave të prokurimit që termat e referencës t'i përpilojnë me inxhinier të komunave dhe jo direkt nga njësia e kërkesës. Kurse sa i përket specifikave teknike komunat si Drenasi dhe Vushtrria nuk kanë kompani hartuese për dizajnimin e projekteve ndërsa inxhinieret e punësuar nuk i përgatisin ato sado të thjeshtë të jenë projektet. Kurse në komunat Lipjan e Skenderaj si pasojë e gabimeve në paramasa e parallogari ka qenë e nevojshme ndryshimi i projektit gjegjësisht shpëputja e kontratave. Kjo ka bërë që projektet të mos realizohen në kohë apo mos të realizohen fare, rrjedhimisht qytetarët janë privuar nga përfitimet e mundshme nga këto projekte.

22. Ky moskujdes ka shkaktuar edhe shpëputje të kontratës për projektin *Ndërtimi i një kopshti - Faza II* '.

Ndarja e procedurës së prokurimit në LOT-e - jo ekonomike

Në rast të kontratave të përbëra nga një sërë punësh, mallrash ose shërbimesh homogjene ose heterogjene, kontrata mund të ndahet në lote (pjesë). Kjo metodë mund të përdoret në veçanti për qëllime të inkurajimit të pjesëmarrësve të bizneseve të vogla dhe të mesme. Kjo gjithashtu mund të bëhet për të siguruar konkurrencë më të gjerë përmes mundësimit të OE më të specializuar që janë në gjendje të furnizojnë vetëm pjesë specifike të mallrave, shërbimeve dhe punëve. Sidoqoftë, ndarja në lote nuk nënkupton ndarjen e vlerës së kontratës ose shmangien nga pragjet e vlerave, pasi që përbëhet nga vlera e përbashkët e loteve.

Projekti ‘Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Drenasit’ me vlerë 388,053 euro është ndarë në tre LOT-e homogjene, ndarje e cila edhe pse në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, ka rezultuar jo ekonomike. Specifikat teknike të tre LOT-eve janë të njëjtat përveç në LOT 1 i cili ka një pozicion ndryshe nga paramasat dhe parallogaritë e dy LOT-eve tjera me vlerë jo materiale (total 3,800 euro). Me ndarjen e procedurës në LOT-e komuna ka paguar 388,083 euro pra 106,546 euro apo 27% më shumë se sa do të paguante sikur mos të kishte ndarë procedurën në LOT-e e rrjedhimisht OE-të nuk do të mund të ofronin me çmime të ndryshme për pozicione të njëjta.

Një gjë e tillë ka ndodhur pasi që OE-të kanë qenë të lejuar të ofertojnë për të gjitha LOT-et por që do të shpërbleheshin me vetëm një LOT, e kjo do të thotë që në rast se tenderuesi ofron çmimin më të ulët në më shumë se një LOT atëherë ai do të shpërblehet me kontratë për LOT-in që ka vlerën totale të përgjithshme më të lartë. Kjo ka inkurajuar ofertuesit që të kenë çmime të ndryshme për pozicione të njëjta.

Sipas zyrtarëve komunal, Drejtoria e Infrastrukturës Publike ka propozuar të ndahet në LOT-e procedurën pasi vlera ishte e madhe dhe hezitonin me frikën në dështimin e procedurës dhe po ashtu donin të ju jepnin mundësi më shumë NVM-ve të konkurrojnë në proces.

Kontrata të nënshkruara pa vend punim të saktë të investimit

Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të tregojnë b) një përshkrim të përgjithësuar të vend punimit dhe/ose ndërtesës (lokacionit, madhësisë, sasisë së pjesëve të ndërtesës, elementet strukturore, instalimet ekzistuese, etj) dhe synimi i fushëveprimit të vend punimit/ndërtesës.

Te kontrata ‘Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Drenasit’ janë nënshkruar kontratat në vlerë prej 388,053 euro për tre LOT-e pa e specifikuar në dosjen e tenderit vend punimin e saktë se ku do të realizohen punët nga OE-të fituese. OE-të janë njoftuar rreth vendit se ku do të kryhen punimet vetëm pas nënshkrimit të kontratës, pasi nuk kishte as projekt ekzekutiv dhe as matje gjeodezike.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së projektit kryesor i cili do ta orientonte investimin. Nënshkrimi i kontratave pa përcaktuar vend punimin rritë rrezikun e menaxhimit të duhur të kontratës, puna e kontraktuar mos të jetë e mjaftueshme apo të jetë e tepërt për vend punimin ku do bëhet investimi, puna mund të mos realizohet në tërësi dhe në përputhje me prioritetet.

Mos konfiskimi i sigurisë së tenderit

Autoriteti Kontraktues do të konfiskoj sigurimin e tenderit në situatat e mëposhtme: OE fiton kontratën por refuzon ose dështon: a. Të ofroj sigurimin e ekzekutimit, siç specifikohet në DT; b. Të respektoj kushtet tjera që paraprijnë nënshkrimin e kontratës, siç specifikohet në DT.

Te procedura e prokurimit 'Ndriçimi Ribar i Madh dhe Zllakuqan' LOT 5 Komuna Lipjan nuk i kishte konfiskuar ofertuesit më të lirë sigurinë e tenderit. Komuna kishte bërë kërkesë për sqarim dhe kishte kërkuar që OE të sjellë dokumentet e kërkuara me DT dhe Njoftimin për kontratë, mirëpo OE nuk ishte lajmëruar dhe as nuk kishte dërguar sqarimet shtesë. Komuna pastaj ka përzgjedhur OE-në e dytë me radhë me çmimin më të lirë, mirëpo nuk kishte ndjekur procedurat tjera rreth konfiskimit të sigurimit të tenderit për ofertuesin më të lirë i cili nuk i është përgjigjur Komunës.

Sipas zyrtarëve komunal, kjo ka ndodhur pasi që komuna nuk aplikon një praktik të tillë si dhe nga fluksi i madh i punëve.

Komuna ka paguar 6,392 euro më shumë duke shpërblyer OE-në e dytë të përgjegjshëm, ndërsa me konfiskimin e sigurisë së tenderit do të mund të zbuste diferencën e paguar. Përveç kësaj, mos konfiskimi i sigurisë së tenderit, i jap OE-së në fjalë hapësirë që të ofertoj prapë dhe përsëri mos të respektoj kushtet e parapara për nënshkrim të kontratës, duke shkaktuar vonesa në nënshkrimin e kontratës.

Komisioni vlerësues pa anëtar të fushave relevante

Numri i anëtarëve të komisionit vlerësues do të varet nga vlera dhe kompleksiteti i aktivitetit të prokurimit, por në të gjitha rastet do të përbëhet nga jo më pak se tre anëtar dhe numri gjithnjë do të jetë tek. Komisioni do të përbëhet nga anëtar me aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë, relevante me kërkesat e prokurimit.

Te procedura e prokurimit 'Ndriçimi Ribar i Madh dhe Zllakuqan' Komuna e Lipjanit kishte emëruar në komision të vlerësimit të ofertave si kryetar të komisionit zyrtarin e prokurimit dhe dy anëtar të tjerë të cilët nuk ishin ekspert të fushës së kërkuar për kryerjen e punëve të këtij projekti.

Anëtarët e këtij komisioni ishin të fushave: zyrtar ligjor, zyrtar i prokurimit dhe zyrtar i shërbimeve publike.

Mungesa e ekspertëve të fushës në komisione vlerësuese, rrezikon që komisioni mos të bëjë vlerësim të duhur, të mos jetë në gjendje të vlerësoj drejtë dhe pastaj gjatë realizimit të kontratës mos të arrihen objektivat e caktuara të projektit.

Dosja e tenderit e pa plotësuar tek pjesa e identifikimit financiar

Identifikimi Financiar' është pjesë e dosjes standarde të Tenderit për punë, dhe plotësohet nga fituesi i kontratës. I njëjti (formular) duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Gjatë verifikimit të dosjes së tenderit kemi vërejtur se në Komunitat Lipjan e Vushtrri nuk është plotësuar forma standarde e dosjes mbi identifikimin financiar, gjegjësisht nuk janë dhënë numri i llogarisë bankare në të cilën Komuna do të bëjë pagesat për punët e kryera për projektet në vijim:

Tabela 4. Projektet ku mungon identifikimi financiar

Komuna	Projekti	Vlera në euro
Lipjan	Ndriçimi në Ribar i Madh dhe Zllakuqan	85,631
	Ndriçimi në Kravishtë	67,345
Vushtrri	Ndërtimi i trotuarit në Stanovc i Epërm	38,911

Mos plotësimi i identifikimit financiar ishte si pasojë e mungesës së kujdesit nga departamenti i prokurimit kundrejt plotësimit formal të dosjes së tenderit nga operatorët ekonomik. Megjithatë këto pagesa janë kryer në llogaritë e duhura.

Mos plotësimi i identifikimit financiar dhe azhurnimi i tij sipas nevojës rrezikon që Komuna të bëjë pagesa të faturave në llogari të gabuara dhe në këtë mënyrë të shkaktoj vonesa deri në sqarimin e gabimeve apo kthimin e mjete, e në raste edhe më ekstreme të dëmtohet buxheti i komunës.

3.3 Dobësi në menaxhimin e kontratave

Menaxheri i kontratës duhet të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës. Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës. Të menaxhoj procedurën e pranimin teknik dhe të sigurohet se ecuria e projektit po mbulohet me dokumentet dhe raportet e nevojshme.

Menaxhimi i kontratave në Komunitat Drenas, Lipjan, Vushtrri dhe Skenderaj kryesisht bëhet sipas kërkesave ligjore. Posedojnë planin e menaxhimit të kontratës edhe pse nuk e azhurnojnë me kohë për ndryshimet e ndodhura gjatë realizimit të kontratës si dhe jo secili menaxher i projektit përpilon raporte për mbarëvajtjen e projektit. Nga menaxhimi i kontratave të audituara për vitin 2021 kemi hasur në këto mangësi:

Mos realizim i projekteve si pasojë e shkëputjes së kontratave

Dy kontrata të nënshkruara për projekte kapitale sipas marrëveshjes me donatorët dhe Komunitat e Skenderajt janë shkëputur me marrëveshje me palët kontraktuese dhe komuna. Projektet me këto kontrata dhe kushte nuk janë realizuar.

Projekti ‘Shijoni qytetin në këmbë në rrugën Ilaz Kodra’

Projekti ‘Shijoni qytetin në këmbë në rrugën Ilaz Kodra’ në vlerë prej 149,390 euro me kontratën e nënshkruar në vitin 2021 kishte realizim dhe pagesë në vlerë prej 16,763 euro apo 11% të vlerës së përgjithshme të kontratës. Kontrata për këtë projekt ishte shkëputur për arsye të problemeve pronësore ku për një kohë të gjatë nuk ishte i mundur zhvillimi i punëve. Kjo kontratë ishte shkëputur më mirëkuptim nga të dyja palët. Edhe pse problemet pronësorë ende nuk ishin zgjidhur, prapë se prapë komuna me buxhetin e saj në vitin 2022 ka zhvilluar procedurë tjetër të prokurimit dhe ka lidhur kontratë tjetër me vlerë rreth 189,118 euro.

Foto 1. Projekti i planifikuar të realizohet në Komunitat e Skenderajt




Foto 2. Pjesa e realizuar e Projektit në Komunën e Skenderajt



Projekti 'Ndërtimi i një kopshti - Faza II'

Projekti 'Ndërtimi i një kopshti - Faza II' në vlerë prej 163,467 euro e nënshkruar në korrik të vitit 2021 si bashkëfinancim mes Komunës së Skenderajt dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal është realizuar në vlerë prej 49,373 euro apo 30% e vlerës totale të kontratës. Pagesa është bërë nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe projekti ka mbetur i papërfunduar. Në fotografiminë 3 shihet se si është planifikuar të dukej projekti, ndërsa nga ekzaminimi fizik (fotografia nr. 4) shihet gjendja në të cilën ishte projekti në kohën kur është kryer puna në terren (nëntor 2022). Ndërtimi i bërë deri më tani ka filluar të dëmtohet dhe projekti është ende i papërdorshëm. Në këtë projekt nuk ishte punuar gjatë vitit 2022 dhe Ekzekutivi i Komunës ka konfirmuar se edhe pse i nevojitet kopshti nuk ka mjete të parapara dhe nuk do të investojë as në vitin 2023 në këtë projekt.

Foto 3. Projekti i planifikuar të realizohet në Komunën e Skenderajt



Foto 4. Gjendja e projektit në Komunën e Skenderajt



Projekti në fjalë sipas kontratës do të duhej të përfundonte për dy vite, mirëpo si pasojë e mosparashikimit të buxhetit për vitin vijues, buxhet ky i cili do të duhej të planifikohej nga komuna dhe kthimi i mjeteve të pa shpenzuara tek donatorët për vitin që kanë përfituar grantin, projekti nuk është përfunduar në kohë. Si rrjedhojë, OE duke u bazuar në ngritjen e çmimeve të materialeve dhe mos përputhshmërinë së parallogarisë dhe paramasës me gjendjen faktike në terren, ka bërë kërkesën për shkëputjen e kontratës. Shkëputja e kësaj kontrate është bërë me mirëkuptim në mes palëve.

Projekti në fjalë kishte edhe fazën e parë, ku ishin shpenzuar 69,721 euro nga buxheti i komunës. Duke e pasur paraysh që projekti nuk është i përdorshëm ende, humbja nga buxheti llogaritet të jetë në vlerë prej 119,094 euro (shpenzimet në vlerë 69,721 euro nga buxheti i komunës për fazën e parë dhe 49,373 euro nga buxheti i MZHR për fazën e dytë).

Ndryshimi i akseve pa aprovim paraprak nga ZKA

Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit, si dhe ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA.

Nga ekzaminimi fizik i projektit 'Ndriçimi në Ribar të Madh dhe Zllakuqan' në Komunën e Lipjanit në vlerë 86,081 euro kemi vërejtur se janë bërë ndryshime në akset e planifikuara²³ me ato të realizuara. Ndryshimet kanë ndodhur për ndërrimin e vendit të ekzekutimit të punimeve dhe akseve të planifikuara. Ky ndryshim i punëve edhe pse nuk ka implikim

23. Ndryshimet; Në Aksin 1 është realizuar deri te stacionazha 756m' - janë zbritur rreth 270m'
Në Aksin 7 është realizuar deri te stacionazha 297 m' - janë zbritur rreth 240m'
Në Aksin 9 është zbritur komplet = 338 m'
Në Aksin 10 është realizuar 729 m' janë zbritur rreth 108m'
Aksin 11 është realizuar sipas projektit 617m' dhe është zgjatur rreth 135 m'
Kurse në Zllakuqan, në Aksin 2 janë zbritë rreth 364 m'.

financiar nuk ka aprovim nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe as aneks kontratë të nënshkruar për këtë qëllim.

Sipas zyrtarëve komunal, ata nuk e kanë vlerësuar të nevojshme marrjen e aprovimit sepse ndryshimi në para-masë nuk kishte implikim financiar.

Ndryshimi i paramasës respektivisht kushteve të kontratës, në mungesë të aprovimeve të duhura dhe dëshmive se janë bërë analiza specifike për këto ndryshime, rrezikon që realizimi i punëve të mos jetë në përputhje me kërkesat e projektit dhe krijon mundësinë për manipulime me pozicionet dhe paramasat e tenderit fillestar. E në rastin konkret ndriçimi mos të bëhet për qytetarët të cilët kanë bërë kërkesë.

Zgjatje e paarsyeshme e afatit të punëve

Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit.

Te kontrata ‘Ndriçimi në Ribar të Madh dhe Zllakuqan’ dhe ‘Ndriçimi në Kraishtë’ ishte bërë vendimi mbi zgjatjen e afatit për realizimin e punëve dhe kontratës për 16 dhe 26 ditë pune. Arsyeja ishte mos arritja e shtyllave të ndriçimit në kohë, mirëpo neve nuk na është ofruar dëshmi për kohën kur është bërë porositja por vetëm fatura e liferimit. OE me njoftim për kontratë e ka pasur të qartë që ka 60 ditë kohë të realizoj kontratën dhe ka pranuar, kështu që zgjatja e afatit për çështje operationale të vet OE-së është jo e arsyeshme. Komuna nuk e ka parë të arsyeshme të penalizoj vonesën.

Zgjatja e afatit ka ndikuar që projektet respektivisht ndriçimi i fshatit të jetë i vonuar krahasuar me planin.

Ditarët e punës të mbajtur jo sipas KVK-ve të nënshkruara

Kushtet e veçanta të kontratës kanë theksuar se menaxheri i projektit dhe inxhinier i Hidros duhet të mbajnë dhe nënshkruajnë fletët e ditarit të punës për çdo punë që kryhet dhe ditë që kalon sipas planit dinamik.

Te projekti ‘Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Drenasit’, ditari i punës për kontratën e LOT-it III nuk ishte nënshkruar në përputhje me kërkesat e KVK-së. Tek ky ditar i punës nuk kishin nënshkruar as Inxhinieri i Hidros dhe as menaxheri i projektit mbikëqyrës nga Komuna.

Mos nënshkrimi i ditarit të punës, tregon që punët nuk janë aprovuar zyrtarisht nga personat përgjegjës për mbikëqyrje. Kjo rrit rrezikun se këta të fundit mund të mos kenë qenë në terren gjatë kryerjes së punëve për të cilat ishin përgjegjës për mbikëqyrje, e kjo rrezikon që punët mos të kryhen sipas kontratës.

3.4 Rezultatet e synuara dhe përfshirja e grupeve të marginalizuara në projektet e financuara nga GPK²⁴

Objektiva kryesore e GPK-së është përmirësimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët, prandaj edhe projektet duhet të kryhen me kohë dhe të jenë të qasshme dhe të gatshme për shfrytëzim nga ana e qytetarëve. Në mënyrë që komuna të ofrojë shërbime të duhura për qytetarët, duhet të sigurohet që objektivat për investime kapitale të jenë të vendosura në planet strategjike dhe vjetore, si dhe të jenë të dokumentuara sipas kriterëve dhe kategorive: strategjike, operative, financiare dhe të pajtueshmërisë.

Komunat që ishin fushëveprim e këtij auditimi, nuk na kanë ofruar procesverbale mbi takimet dhe dëgjimet buxhetore për vitin 2021²⁵, por na janë ofruar shpalljet e dëgjimeve buxhetore dhe disa nga kërkesat e qytetarëve për realizimin e disa projekteve.

Për të parë edhe pikëpamjen e qytetarëve mbi realizimin e projekteve sipas pritshmërive të tyre²⁶ ne kemi anketuar disa qytetarë të rastit ku janë realizuar projektet dhe më poshtë kemi paraqitur rezultatet nga përgjigjet e tyre dhe pikëpamjen e tyre nëse ndihen të përfshirë apo jo në vendimmarrje dhe iniciativa. *Anketën me pyetjet i gjeni në shtojcën III.*

Ne kishim qëllim edhe vlerësimin e përfshirjes së grupeve të marginalizuara në politika të komunave, shoqëri dhe në procese të investimeve kapitale. Ne kemi përpiluar një pyetësor, të cilin e kemi dërguar tek 21 komunat përfituese të GPK-së alokimi i të cilave ju është bërë në vitin 2021, ku 19 prej tyre na janë përgjigjur, rezultati i të cilave është prezantuar më poshtë. *Pyetësorin e dërguar mund ta gjeni te shtojca IV.*

Komunë pa strategji komunale dhe projekte të realizuara jo sipas planit të punës

Sipas tabelës 5 vërehet se disa nga projektet e realizuara me fondet e GPK nuk kanë qenë pjesë e planit të punës a as të planit të prokurimit. Komunat kryesisht nuk kanë kriterë të shkruara se si prioritizohen projektet për investime kapitale (nuk janë të formalizuara) dhe nuk kanë politika ose praktika të dëshmuara se të gjithë qytetarët²⁷ pa dallim përfshihen në planin e investimeve. Përveç shpalljeve të dëgjimeve buxhetore në rrjete sociale dhe në faqen zyrtare të Komunave ne nuk kemi hasur në ndonjë praktikë tjetër shtesë për përfshirjen e qytetarëve, e me fokus grupet e marginalizuara²⁸.

24. Komunat Drenas, Vushtrri, Lipjan dhe Skenderaj

25. Komuna Drenas, Lipjan, Skenderaj dhe Vushtrri

26. Rezultatet e anketave të realizuara tek tri komunat që kanë realizuar projektet janë te Rezultatet e synuara të GPK-së jo kënaqshëm të arritura

27. Fokus të veçantë grupet e marginalizuara

28. Si p.sh. Ftesa direkte dhe takime të rregullta për këto grupe, iniciativë nga komuna që ti informojnë të gjitha zyret përfaqësuese për këto grupe mbi investimet e planifikuara e sidomos në ato që ndikojnë direkt te ta. Nuk ka dëshmi ose procesverbale.

Tabela 5. Planifikimi i projekteve të audituara për vitin 2021

Komuna	Përshkrimi	Vlera e audituar në euro	E planifikuar me Strategjitë komunale për zhvillim	Pjesë e planit të punës së ekzekutivit	Pjesë e planit të prokurimit
Drenas	Rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve në Komunën e Drenasit LOT I -III	388,050	Po	Po	Po
Lipjan	Ndriçimi publik në Ribar të Madh	85,631	Po	Po	Jo
	Ndriçimi Publik në Kraishtë	67,345	Po	Po	Jo
Vushtrri	Ndërtimi i trotuarit në fshatin Stanoc i Epërm	38,911	Nuk ka përpiluar Strategji Komunale deri në fund të vitit 2021	Jo	Jo
Skenderaj	Shijoni qytetin në këmbë në rrugën Ilaz Kodra në Skënderaj	149,390	Po	Jo	Jo
	Ndërtimi i një kopshti - Faza II	163,467	Jo	Jo	Jo
Mitrovica e Jugut Leposaviq Shterpc	Grantet e pashpenzuara	324,073 64,362 3,449	NA	NA	NA
Prizren Pejë	Kthimi i fondit të donacionit	140,966 18,750	Po Po	Po Po	Po Po

Mos përfshirja e projekteve në plane qoftë të punës apo prokurimit, mund të shpijë në investime të pa analizuara si duhet dhe jo të mbështetura në prioritete. Kjo mund të shkaktojë edhe obligime për komunat për vitet vijuese dhe të marrin buxhet nga projektet tjera të planifikuara.

Arritja e rezultateve të synuara të GPK-së

AK-të duhet që investimet e tyre ti shpërndajnë në atë mënyrë, që në to të kenë qasje të gjitha grupet e qytetareve (pa dallim feje, race, etnie, gjinie, bindje politike etj). Komunat duhet të trajtojnë të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë në shpërndarjen e shërbimeve karshi nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve, në mënyrë që të kenë një menaxhim efektiv dhe efikas.

Raportet e auditimit për vitet 2018-2020 potencojnë se ka mungesë dokumentimi për priorizimin e projekteve të financuara nga GPK. Po ashtu ka qytetarë të pa informuar

për realizimin e projekteve të caktuara, ku kjo praktikë nuk siguron që projektet kanë qenë gjithëpërfshirëse dhe kanë ofruar mundësi përfitimi optimal për qytetarët²⁹.

Informimi i qytetarëve rreth nismave investive në vitin 2021 është bërë kryesisht njëjtë nga pjesa më e madhe e komunave audituese, përmes dëgjimeve buxhetore. Për dallim, komunat përveç njoftimit në faqen zyrtare dhe në objektin e saj, këtë vit kanë shfrytëzuar edhe rrjetet sociale dhe mjetet tjera të komunikimit për të ftuar qytetarët. Mirëpo, për pjesën e qytetarëve të cilët nuk kanë mundësi të shfrytëzojnë këto aplikacione, komunat nuk kanë ndonjë iniciativë për t'i ftuar në dëgjime publike.

Pasi objektiva kryesore e GPK-së është përmirësimi i kushteve të jetesës për qytetarët, projektet duhen të jenë të qasshme dhe të gatshme për shfrytëzim nga ana e të gjithë qytetarëve. GPK-ja e ka arritur këtë qëllim duke i ndihmuar komunat e audituara në: shëtitore/trotuarë, ndriçim publik për qytetarët, përmirësim të infrastrukturës së kanalizimive për qytetarët duke kontribuar në përmirësimin e ambientit e ujërave të zeza dhe kopshte për fëmijë³⁰.

Nga katër komunat e audituara për menaxhimin e projekteve kapitale, dy prej tyre (Komuna Lipjan dhe Vushtri) kanë përfunduar projektet brenda vitit 2021 dhe të njëjtat janë në shfrytëzim nga qytetarët. Edhe pse sipas ekzaminimit fizik dhe anketave me qytetarët cilësia e këtyre investimeve mbetet për tu dëshiruar dhe ka nevojë për mirëmbajtje të rregullta, shfrytëzohen dhe kanë qenë të nevojshme të investohet.

Foto 5. Ndriçimi në Ribar të madh dhe Zllakuqan



Foto 6. Ndërtimi i trotuarit në Stanoc i Epërm

29. Raportet e auditimit për projektet e financuara nga GPK 2018-2020

30. Edhe pse si projekt ka mbetur i përfunduar si pasojë e shkëputjes së kontratës.

Siç shihen në dy fotot e paraqitura mirëmbajtja e këtyre projekteve është e nevojshme të konsiderohet nga komunat. Tek foto 5 fshati mbetet pa drita shpesh sepse modeli i vendosur është i një cilësie më të ulët dhe nuk ofron në vazhdimësi ndriqim për fshatin. Ndërsa ndërtimi i trotuarit siç po shihet nga foto lartë ka filluar të shembet dhe nuk është riparuar. Te të dy këto kontrata ka përfunduar periudha e garancionit dhe se për këto investime, Komuna nuk ka siguruar mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre.

Kurse te Komuna Drenas projekti 'Rehabilitimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Komunën e Drenas' nuk ka përfunduar ende dhe te Komuna Skenderaj projektet 'Shijoni qytetin në këmbë në rrugën Ilaz Kodra në Skënderaj' dhe 'Ndërtimi i një kopshti - Faza II' janë shkëputur kontratat.

Si rrjedhojë në Komunën e Drenasit te projekti në fjalë tek LOT II dhe LOT III gjatë ekzaminimit fizik kemi hasur në mos rregullim të pjesës pas rehabilitimit të kanalizimit e cila mund të rezultojë në pengesë për qytetarët.

Foto 7. Komuna Drenas LOT II




Foto 8. Komuna Drenas LOT III



Në rastin e Komunës së Skenderajt te projekti Ndërtimi i një kopshti - Faza II objekti i planifikuar të ndërtohet si kopsht nuk ka vazhduar si pasojë e shkëputjes së kontratës dhe e cila tash ka filluar të dëmtohet. Siç e kemi konstatuar gjatë verifikimit fizik kopshti ka mbetur total i pashfrytëzuar dhe nëse vazhdohet me gjatë pa ndonjë iniciativë nga komuna për përfundimin e projektit nuk mund të shfrytëzohet më për asgjë. Mjetet e paguara për fazën e parë dhe pjesa e fazës së dytë³¹ kanë rezultuar me humbje të buxhetit. Vlera për para në këtë rast do të humb³².

Bazuar në anketat/intervistat me qytetarët lidhur me projektet e audituara, të cilën mund të gjeni në shtojcën III, më poshtë kemi paraqitur rezultatet për projektet e realizuara në tri komuna Lipjan, Vushtrri dhe Drenas (projekti i përfunduar 90%). Në këto tri komuna gjithsej janë anketuar/intervistuar 29 qytetarë të rastit.



31. Paga e bërë në vlerë prej 49,373€ nga MZHR

32. Kontrata 'Ndërtimi i çerdhes Faza I' në vlerë 69,720 euro dhe pagesa nga kontrata 'Ndërtimi i çerdhes Faza II' 49,373 euro, në total 119,093 euro.

Nga përgjigjet e të anketuarëve rezulton se projektet e investuara kanë qenë kërkesë e banorëve të fshatrave (rreth 80%), 86% e banorëve janë shumë të kënaqur me investimet në këto projekte ndërsa 14% janë mesatarisht . Kryesisht informimi mbi investimin e planifikuar i bëhet të parit të lagjes ose fshatit, kështu që përfaqësohen në kuvende rregullisht. Të gjithë banorët kanë arritur ti shfrytëzojnë projektet, prej tyre 90% janë shumë të kënaqur, dhe e kanë pranuar se kanë përmirësuar përditshmërinë e tyre.

Në anketë është përfshi edhe pjesa e komenteve shtesë nga banorët lidhur me projektet e audituara. Rezultatet e komenteve janë si në vijim për secilin projekt:

Tabela 6. Komentet e banorëve gjatë anketimit për projektet përkatëse

Komuna	Projekti	Përmbledhje e komenteve
Drenas	Rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve në Komunën e Drenasit LOT I -III	Pas këtij investimi të gjithë banorëve ju është ofruar mundësia që të lidhen në rrjetin e kanalizimit. Edhe pse pas investimit të LOT II dhe III nuk është kthyer pjesa e investimit në gjendjen si ka qenë, qëllimi është arritur.
Lipjan	Ndriqimi publik në Ribar të Madh dhe Zllakuqan	Sipas banorëve vendosja e ndriçimit ka ndikuar në përmirësimin e sigurisë së banorëve; ndriçimi është i mirë, mirëpo vlen të theksohet se dritat janë të dobëta dhe ka ndërprerje të dritave herë pas here. Komuna ka të kontraktuar edhe kompaninë për mirëmbajtjen dhe rregullimin e dritave.
	Ndriqimi Publik në Kraishtë	
Vushtrri	Ndërtimi i trotuarit në fshatin Stanoc i Epërm	Duhet të vazhdohet ndërtimi i trotuarit, pasi një pjesë nuk është ndërtuar si pasojë e një pozicioni më së të nevojshëm që të shtohet. Po ashtu komuna duhet të kujdeset për cilësinë dhe mirëmbajtjen e trotuarit, pasi ka dëmtim të tij.

Përfshirja e grupeve të marginalizuara në proceset komunale

Në mënyrë që qytetarët të përfitojnë sa më shumë nga projektet në të cilat investohet, ato duhet të jenë të planifikuara nga komuna ose të jenë në strategjitë/objektivat e komunës. Për më tepër, projektet duhet të jenë me interes për të gjithë qytetarët dhe në përfitim të tyre.


Në auditimet e fondeve të GPK për vitet 2018-2020 theksohet qartë që politika për përfshirjen e grupeve të marginalizuara në proceset e vendimmarrjes janë të mangëta dhe teknika për integrimin e tyre në procese të vendimmarrjes janë të njëjta për të gjithë qytetarët. Nuk janë përdorur tjera iniciativa.

Ndërsa sa i përket vitit 2021, komunat e audituara shihet që kanë politika dhe përfshirje të grupeve të marginalizuara. Nëntë komunat e audituara për vitin 2021 njoftimin për iniciativat investive e bëjnë përmes rrjeteve dhe aplikacioneve sociale, ueb faqen e

komunave dhe në tabelën e njoftimeve të komunës. Mirëpo nuk dihet nëse këto grupe kanë qenë pjesëmarrëse në këto dëgjime buxhetore pasi që nuk mbahet një evidencë e tillë.

Për të parë gjendjen e përfshirjes së grupeve të marginalizuara në procese komunale përveç nëntë komunave që kemi trajtuar më lartë si entitete pjesë e këtij auditimi, ne kemi dërguar një pyetësor në të gjitha komunave të cilëve ju është bërë alokimi i granteve të GPK-së në vitin 2021 (gjithsej 21 komuna). Nga gjithsej 21 komuna vetëm dy³³ prej tyre nuk na janë përgjigjur.

Grafiku 10. Rezultatet nga pyetësori për grupet e marginalizuara.



Sa i përket përfshirjes së grupeve të marginalizuara në politika dhe strategji të komunave siç shihet në diagram, shumica e komunave të anketuara janë përgjigjur se kanë politika për grupet e marginalizuara dhe i kanë përfshirë në plane zhvillimore komunale, ndërsa komunat që nuk kanë politika të tilla do të konsiderojnë për vitet në vijim. Si lloje të politikave të raportuara nga komunat të cilët i kanë përfshirë këto grupe janë strategjitë komunale, plane vjetore të punës, në strategjitë për komunitetet jo shumicë, përparësi në konkurse, bursa shkollore dhe kanë themeluar komitete për këto grupe. Disa komuna kanë kordinatorë³⁴ të cilët merren direkt me këto grupe dhe të tjerët kanë grupe punuese ose komitete të cilat trajtojnë çështjet që i përkasin këtyre grupeve por jo në mënyrë sistematike.

Bashkëpunim me OJQ-të e secilit grup të marginalizuar kanë rreth 90% e komunave përfituese të GPK për vitin 2021, duke organizuar tryeza të rrumbullakëta për arsim të minoriteteve dhe subvencionim të organizatave në vijim:

33. Komuna Mitrovica e Veriut dhe Komuna e Kllokot-it

34. Psikolog komunal, zyrtar për komunitete, barazi gjinore, të drejtat e njeriut, integrim, zyrtarja për ndihmë juridike falas, zyrtarja për mbrojtje nga diskriminimi

- organizatat përfaqësuese për personat me aftësi të kufizuara;
- organizatat për mbrojtjen e të drejtave të grave;
- shoqatat e dala nga lufta;
- këshillin e veprimt rinor lokal;
- qendrën strehimore të të moshuarve në Prishtinë e Gjinoc;
- në projektin e furnizimit me pajisje të teknologjisë;
- fëmijët me autizëm dhe nevoja të veçanta;
- shoqata të shurdh-memecëve, pensionistëve dhe të verbërit;
- për nanat vetushqyese me banim social;
- OJQ për komunitete jo shumicë; dhe
- personat e riatdhesuar.

Të gjitha komunat e anketuara mundësojnë lehtësira për grupet e marginalizuara, përveç Komuna e Novobërdës, por, kjo komunë nuk ka pasur as kërkesa nga grupe të tilla. Disa nga lehtësitat e ofruara nga komunat janë si në vijim:

- dhënia në shfrytëzim e objektit të Komunës për Qendrën për mbrojtjen e drejtave të Grave, Këshillit të veprimt rinor lokal, Shoqatave të dala nga lufta, Qendrave Rehabilituese;
- lirimet nga pagesa për shërbime administrative e shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara, lirimet nga pagesat e çerdhes për nënat kryefamiljare, lëshime të dokumenteve personale për komunitetet jo shumicë falas dhe subvencionim i shpenzimeve të transportit, karburantit dhe bursa për student; dhe
- shenjëzimi i parkingjeve për personat me aftësi të kufizuara dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara në komunë.

Rreth 80% e komunave kanë integruar grupet e marginalizuara në iniciativat investive, po ashtu kanë realizuar edhe projekte të cilat direkt kanë ndikuar tek grupet e marginalizuara. Mirëpo, edhe pse fondi i GPK-së ka qenë i dedikuar edhe për këto grupe, vetëm rreth 10% nga gjitha projektet e financuara nga GPK janë realizuar drejtpërdrejtë për këtë qëllim.

Vlen të theksohet se Komunat³⁵ e audituara për vitin 2021 kanë financuar projekte direkt për këto grupe, mirëpo jo nga fondi i GPK-së. Si përfundim deri më tani nuk ka qenë praktikë e komunave që të vlerësojnë se sa janë të kënaqur grupet e marginalizuara me përfshirjen/integrimin e tyre nga komunat, mirëpo disa³⁶ prej tyre kanë pranuar edhe mirënjohje në dokumente e vlerësime sa i përket kënaqshmërisë. Grupet punuese dhe anketat janë nisma që komunat pritet t'i marrin për bazë në vitet në vijim për këtë çështje.

35. Komuna Drenas, Lipjan

36. Komuna e Drenas ka pranuar mirënjohje nga grupet e marginalizuara, në bazë të analizës dhe vlerësimit që bëhet nga MAPL dhe organizata e huaja Komuna e Lipjan është vlerësuar si përkrahëse e grupeve të marginalizuara, gjatë takimeve dhe konsultimeve Komuna e Rahovecit, Vushtrri, Hani i Elezit, dhe Suharekë janë falënderuar për përkrahjen e tyre.

4 Konkluzionet

- Përkundër që menaxhimi i Grantit të Performancës Komunale është përcjellë me disa mangësi, siç janë alokimi i fondeve në dy mënyra e që ka rezultuar me vonesa në finalizimin e projekteve, pastaj fondet e ndara nga MAPL janë fonde të dedikuara dhe nuk mund të bartën, fondet e DEMOS/Helvetas janë përdorur edhe për financimin e projekteve jashtë GPK-së dhe kishin mbetur obligime të papaguara për vitin vijues për komunat, prapë se prapë ky Grant ka pasur rezultate pozitive në përmirësimin e jetës së qytetareve, duke ju ofruar atyre infrastrukturë më të zhvilluar në komunat ku jetojnë. Përveç realizimit të projekteve, ky grant kishte ndikim pozitiv edhe në përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në stimulimin e komunave për integrim më të madh të grupeve të marginalizuara në këto procese.
- Menaxhimi i projekteve është përcjellë me mangësi të ndryshme dhe këto procese ka nevojë për t'u përmirësuar. Mangësitë e identifikuar që nga inicimi i kërkesave për prokurim e deri në përmbyllje të kontratave, tregojnë që komunat përfituese kanë nevojë t'u kushtojnë vëmendje më të madhe zhvillimit të procedurave.
 - Mos kryerja e duhur e analizave dhe vlerësimit të nevojave dhe mos koordinimi mes departamenteve kishte rezultuar në diferenca mes planit dhe realizimit, këto diferenca ishin nga 26% deri në 71%. Mos përpilimi i specifikave të qarta, paramasave dhe parallogarive jo të bazuara në terren, kanë ndikuar në vonesa për përfundimin e punëve apo shkëputje të kontratave apo edhe me humbje të buxhetit pasi që një projekt në vlerë prej 119,094 euro (i financuar nga komuna dhe MZHR) është ende i papërdorshëm dhe ka filluar të dëmtohet. Ndërsa mos plotësimi i identifikimit financiar rrezikon që komunat të bëjnë pagesa në llogari të gabuara, megjithatë pagesat e audituara ishin kryer në llogaritë e duhura. Mos konfiskimi i sigurisë së tenderit u lejon operatorëve ekonomik që të jenë të papërgjegjshëm edhe në procedurat e ardhshme e rrjedhimisht komunave u shkakton vonesa deri në kontraktimin e punëve.
 - Ndarja e procedurës së prokurimit në LOT-e edhe pse është në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka rezultuar jo ekonomike. Të njëjtat punë do të mund të kryheshin për 106,546 euro me lirë se sa janë kontraktuar sikur procedura mos të ishte ndarë në LOT-e rrjedhimisht OE-të nuk do të kishin mundësi të ofertonin me çmime të ndryshme për pozicionet e njëjta.
 - Mungesa e nënshkrimeve në fletët e ditarit të punës, ndryshimi i punëve pa aprovim paraprak nga kreu i organizatës dhe kohëzgjatja e afateve për realizim të punëve pa arsye dhe pa zbatuar penalet, rezulton me pasiguri se puna është kryer realisht dhe në përputhje me kushtet e kontraktuara dhe po ashtu krijon vonesa te qytetarët që të përfitojnë nga projektet në të cilat është investuar.

- Edhe pse financimi i GPK-së ka treguar ndikimin e vet në përmirësimin e menaxhimit financiar të komunave dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, që janë objektivat kryesore të këtij Granti, shihet se ende ka nevojë për përmirësim në menaxhimin e këtyre projekteve për të maksimizuar përfitimin e qytetarëve nga këto investime. Vëmendje e shtuar duhet të i kushtohet cilësisë së investimit dhe të mirëmbajtjes, kurse të projektet të cilat nuk janë realizuar ende të rishikohen planet e punëve për të përfunduar sa më shpejtë projektet sepse kanë filluar edhe të dëmtohen para se të finalizohen punët. Edhe pse në vitin e fundit kishte iniciativa për të rritur përkrahjen ndaj grupeve të marginalizuara, ende ka vend për të përmirësuar këtë aspekt. Përfshirja më intensive e tyre në vendimmarrje, iniciativa të reja sa i përket ftesave të këtyre grupeve në dëgjime buxhetore dhe shfrytëzimi i granteve për përkrahjen më direkte të tyre, do të ndikonin në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre dhe integrimin e tyre më të madh në shoqëri.

5 Rekomandimet

Me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të Grantit të Performancës Komunale dhe rritjes së ndikimit të tij në mirëqenien e qytetarëve, ne kemi dhënë rekomandime për të gjitha palët e përfshira në procese të ndryshme.

Rekomandojmë Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Donatorët që:

- ✓ përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe DEMOS/Helvetas si zbatues i projektit për Donatorët, së bashku me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferëve të analizojnë se si do të bëhet menaxhimi i procesit në fazat e ardhshme që planifikojnë të financojnë. Nisur nga mangësitë e identifikuar dhe procesi i ndryshëm i menaxhimit për të dy fondet, duhet të shqyrtohet hartimi i një qasjeje të re ose të bashkuar e cila do të mundësonte një kontroll më të lehtë dhe më të sigurtë të mbarëvajtjes gjatë menaxhimit të GPK-së.

Rekomandojmë Komunat përfituese që të sigurohen se:

- ✓ projektet e reja identifikohen dhe planifikohen me kohë, se ka koordinim më të mire mes departamenteve dhe në plan përfshihen vetëm kërkesat që duhet dhe mund të kryhen.
- ✓ i'u është kushtuar rëndësi inicimeve të kërkesave për prokurim, janë përpiluar specifika të qarta duke përfshirë në mënyrë mandatore projektet kryesore, janë propozuar terma të referencave dhe paramasat dhe paralogaria janë të bazuara në terren.
- ✓ para se të vendoset për ndarje të punëve në LOT-e është bërë analizë e tregut dhe përfitimeve të mundshme rrjedhimisht të siguroj se është arritur vlerë për paratë e shpenzuar.
- ✓ para nënshkrimit të çdo kontrate është caktuar dhe zyrtarizuar edhe vend punimi për investim. Operatorët ekonomik duhet të jenë të njoftuar se ku do të kryehen punët para nënshkrimit të kontratës.
- ✓ ka kontrolle funksionale në menaxhimin e duhur të procesit të vlerësimit të tenderëve, duke mos emëruar anëtar në komision që potencialisht mund të mos jenë objektiv në vlerësim.
- ✓ menaxhimi i kontratave bëhet sipas obligimeve të performancës dhe në përputhje me termat e kushtet e kontratës. Për çdo devijim apo ndryshim prej kushteve të kontratës duhet të merret aprovim nga Zyrtari Kryesor Administrativ.

- ✓ janë përpiluar dokumente strategjike dhe janë krijuar plane të punës ku janë analizuar paraprakisht projektet në të cilat do të investohet. Komunitat duhet të sigurojnë se planifikimi i bërë rezulton me projekte të realizueshme, cilësore dhe që nuk do t'i kushtojë komunitet mirëmbajtje shtesë.
- ✓ është rritur përfshirja e grupeve të marginalizuara në vendimmarrje dhe procese investive. Të gjejnë teknika të reja mbi integrimin e tyre dhe njoftimin për dëgjimet buxhetore, dhe këto aktivitete të jenë të dokumentuara.

Shtojca I Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Motivi i auditimit

Ky auditim është kërkesë nga DEMOS/Helvetas si zbatues i projektit, e cila ka lidhur kontratë me Zyrën Kombëtare të Auditimit (tutje ZKA). Me auditimin e këtyre projekteve ZKA synon të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme për donatorin dhe qytetarët se si po shpenzohen këto mjete. Nisur edhe nga rezultatet e dalura nga auditimet për GPK-në për vitet 2018, 2019 dhe 2020 ku nxorën në pah disa dobësi në procesin e prokurimit.


Rregullat e GKP-së po ashtu lejojnë një auditim vjetor të posaçëm për një grup komunash të përzgjedhura rastësisht. Kjo për faktin e shqyrtimit të një ose më shumë aspekteve të menaxhimit nanciar publik në lidhje me projektet e investimeve kapitale, për shembull: proceset e prokurimit, procedurat për pranimin teknik të shërbimeve, pagesat, etj.

Përshkrimi i sistemit dhe akterëve tjerë relevant

GPK nënkupton procesin ku komunat përfitojnë mjete financiare në bazë të performancës së tyre në fushat e përzgjedhura. Kushtet minimale që komunat duhet të plotësojnë për t'u kualifikuar që të përfitojnë nga GPK-ja janë: administrimi i shëndoshë financiar³⁷ dhe shpenzimet të jenë 75% ose më tepër të buxhetit për investimeve kapitale. GPK-ja do të bashkë-financohet nga QRK-ja SDC-ja, Suedia dhe Norvegjia.


37. Komunat duhet të kenë raportuar në të gjithë treguesit e SMPK; Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për t'i rishikuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga organet mbikëqyrëse; Opinioni i auditimit duhet të jetë të paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes; Komunat duhet të kenë nënshkruar marrëveshjen tripalëshe të pjesëmarrjes (komuna, MAPL-ja dhe HELVETAS Swiss Intercooperation);

Diagrami 1. Fushat kryesore për përfitimin e GPK-së




Për shpenzimin e GPK-së, zbatohen rregullat ekzistuese të qeverisë (të cilat zbatohen për investimet kapitale në kuadër të Grantit të përgjithshëm) në aspektin e përdorimit të Grantit, planifikimit të Grantit, si dhe të raportimit dhe llogaridhënies. Komunat përdorin procedurat vendore të tenderimit, kontraktimit, menaxhimit të kontratës dhe pranimi teknik. Komunat mund të përdorin Grantin për investime kapitale sipas prioriteteve dhe nevojave të tyre, në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

Diagrami 2: Roli i Donatorëve, MAPL-së dhe komunave në procesin e menaxhimit të GPK-së:



Diagrami 3. Akterët e përfshirë në këtë auditim për projektet e financuara nga DEMOS/ Helvetas janë:



Pyetjet e auditimit

Si ka funksionuar sistemi i Grantit të Performancës Komunale për vitet 2018-2021?

- Si është bërë procesi i shpërndarjes së fondeve dhe i projekteve të realizuara duke përfshirë edhe modelin e rrjedhjes së parasë?
- Si janë trajtuar fondet e pashfrytëzuara dhe ato të kthyerat nga komunat përfituese?
- A është përpiluar raporti përmbledhës mbi GPK-në, të arriturat dhe mangësitë e saj?

Sa kanë arritur përfituesit e granteve për vitin 2021 të menaxhojnë projektet në mënyrën e duhur dhe a kanë siguruar transparencë për shpenzimin e këtyre fondeve?

- Deri në çfarë masë janë respektuar procedurat e prokurimit publik nga përfituesit e granteve?
- A është bërë menaxhimi i kontratave si duhet dhe sipas kushteve të parapara?

A i kanë arritur rezultatet e synuara projektet e financuara nga Donatorët?

- Sa kanë përfituar qytetarët nga projektet e realizuara dhe a janë konsultuar gjatë vendimmarrjes për investim?
- Sa janë përfshirë grupet e marginalizuara në projektet e realizuara?
- A janë shpenzuar fondet ekskluzivisht për qëllimet e synuara?

Kriteret e auditimit³⁸

Shpenzimi i fondeve të financuara nga GPK-ja duhet të jetë vetëm për investime kapitale. Këto investime duhet të arrijnë rezultatet e pritura, do të thotë të jenë lehtë të qasshme dhe në kohë për qytetarët.

Bazuar në këtë kemi vendosur kriteret në vijim:

Kriteret për pyetjen e parë³⁹

- Procesi i shpërndarjes së fondeve burimore bëhet sipas rregullave (objektivat, kriteret, vlerat) dhe periudhave të parapara;
- Fondet e ndara nga dy burimet (61 dhe 10) duhet të përputhen me projektet e realizuara për vitet 2018-2021;
- Projekti i njëjtë nga përfituesit e granteve nuk është shpërblyer nga dy fondet burimore ose të ngjashme;
- Grantet e pashpenzuara për qëllimin e marrë janë kthyer tek donatori;
- Fondet e mbetura të pashfrytëzuara barazohen me pagesat e kryera për projektin e caktuar dhe punët e realizuara;
- Të dhënat në Thesar përputhen me ato të raportuara nga MAPL, DEMOS/Helvetas dhe komuna;
- MAPL dhe Komunitatet përfituese duhet të kenë raportin përmbledhës mbi ecurinë dhe përfundimin e projekteve. Duhet të kenë një pasqyrë mbi të mirat dhe mangësitë e hasura gjatë viteve të realizimit të GPK-së dhe
- Projekti duhet të jetë në përputhje me memorandumun e mirëkuptimit të nënshkruar nga DEMOS/Helvetas dhe komuna përfituese.

38. Për më shumë informata konsultoni ISSAI 300, Criteria, p.7

39. Rregullat e GPK-së për vitin fiskal 2021;

Kriteret për pyetjen e dytë⁴⁰:

- Procedurat e prokurimit (nga planifikimi i projektit deri te nënshkrimi i kontratës) duhet të jenë në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik në Kosovë;
- Projekti duhet të realizohet dhe menaxhohet nga komuna, bazuar në paramasën dhe parallogarinë e kontraktuar;
- Menaxhimi i kontratës duhet të bëhet nga menaxheri i kontratës duke u bazuar në planin e menaxhimit të kontratë dhe kontratën e nënshkruar;
- Shpenzimet duhet të jenë sipas kërkesave dhe punëve të realizuara të mbështetura me dokumente origjinale; dhe
- Pranimi i punëve/mallit është bërë dhe përdoret në përputhje me kontratën e nënshkruar.

Kriteret për pyetjen e tretë⁴¹:

- Komunat duhet të përfundojnë këto projekte brenda vitit fiskal 2021;
- Kërkesat e qytetarëve janë marrë parasysh gjatë prioritizimit mbi investimet e planifikuara nga Komuna (Shpalljet për dëgjime publike, procesverbalet e dëgjimeve publike, takimeve dhe anketimet nga komuna mbi nevojat e qytetarëve dhe grupeve të marginalizuara), trajtimi i kërkesave individuale të qytetarëve etj.
- Projektet duhet të jenë lehtë të qasshme dhe të kenë cilësi në ofrimin e shërbimeve sa i përket shërbimeve administrative, planifikimit hapësinorë, transportit publik, mjedisit, arsimit dhe kujdesit shëndetësor dhe;
- Projektet duhet të jenë të shfrytëzueshme për të gjithë qytetarët. Përparësi të ju jepet rasteve më pak të favorizuara (gjinisë femërore, komunitetet joshumicë, personat me aftësi të kufizuara etj).

40. Rregullat e GPK-së për vitin fiskal 2021; Ligji nr. 04/1-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës

41. Rregullat e GPK-së për vitin fiskal 2021; Plani i punës i komunave për vitin 2021; Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026.

Fushëveprimi i auditimit

Me këtë auditim synojmë që të ofrojmë një vlerësim të mënyrës së financimit të granteve dhe menaxhimit të projekteve.

Fillimisht, kemi bërë një analizë mbi funksionimin e sistemit të shpërndarjes së granteve përgjatë viteve 2018-2021 përfshirë edhe mënyrën e rrjedhjes së parasë, bazuar në raportet e kaluara të auditimit të performancës, verifikimin e listave të projekteve dhe gjendjes që kemi konfirmuar për vitin 2021.

Kurse sa i përket menaxhimit të projekteve për vitin 2021 kemi audituar katër komuna apo gjashtë projekte (Drenas, Lipjan, Vushtrri dhe Skenderaj) të cilat në total shumën e shpenzuar për projekte arrijnë vlerën 825,449euro. Komunitet e përzgjedhura për auditim janë ato të cilave nuk i është bërë auditim financiar nga ZKA për projektet e financuara nga Donatorët për periudhën 2021. Ndërsa në Komunën e Drenasit, projekti⁴² Lot 1 është audituar vetëm në aspektin e arritjes së efektit të qytetarët, me fokus të veçantë të grupet e marginalizuara, pasi që procedurat e prokurimit veçse janë audituar nga ZKA. Arsyeja pse është përzgjedhur ky projekt nga të gjitha projektet komunave tjera është sepse ka kontratën me vlerë më të madhe.

Kurse komunitet Mitrovica e Jugut, Leposaviq dhe Shterpc janë audituar për të kuptuar arsyen e mos shpenzimit të fondeve të pranuar në vlerë prej 391,884euro.

Në fund, sa i përket komunave Prizren dhe Pejë janë audituar kthimi i fondeve në vlerë 159,716euro si transaksione të kryera në vitin 2021. Në mostrim janë përfshirë tri natyrat e proceseve" shpenzimet për punët e kryera për projektet e caktuara, fondet e pashfrytëzuara dhe fondet e kthyer.

Përzgjedhja e komunave dhe projekteve për auditim është bazuar në analizat paraprake dhe fokus ishin projektet që nuk janë audituar më parë. Jemi bazuar në madhësinë e komunës (nga aspekti territorial dhe numri i banorëve), informatën me të dhënat e pranuar nga MFPT për vitin 2021 mbi numrin e personave me aftësi të kufizuara sipas qyteteve, shumën e GPK-së të dhënë komunës, shpenzimeve, numrin dhe llojin projekteve, shtrirjen gjeografike, etj. Projektet e audituara nga auditimi financiar dhe i pajtueshmërisë janë përjashtuar gjatë mostrimit.

Fushëveprimi i auditimit për pyetjen e parë ka përfshirë katër vitet e funksionimit të sistemit kurse pyetja e dytë dhe të tretë kanë përfshirë Grantet e dhëna për vitin 2021. Për këto të fundit janë audituar proceset që nga kërkesat, përfshirja e projektit në planin e prokurimit, procedurat e tenderimit, dhënia e kontratës dhe deri te pranimi i projektit. Ku pastaj do të sigurohemi se këto projekte kanë përfshirë nevojat e të gjithë qytetarëve dhe grupeve të marginalizuara. Do të sigurohemi se objektivat e GPK-së janë arritur.

42. Rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve në Komunën e Drenasit LOT I -III

Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve audituese dhe me qëllim të mbështetjes së konkluzioneve të auditimit kemi zbatuar metodologjinë në vijim:

- Analizimi i shpenzimeve dhe projekteve të dhëna të dy burimeve kryesore të granteve për periudhën 2018-2021;
- Krahاسimi i listës së projekteve të regjistruara në PIP nëse ndonjë nga projektet financuar nga GPK janë financuar edhe nga ndonjë institucion tjetër publik;
- Analizimi i shumës së kontratës me pagesat e realizuara dhe me transaksionet e kthyer;
- Analizimi i raporteve të auditimit për projektet e financuara nga GPK 2018-2020;
- Evidentimi i përparësive dhe mangësive për pagesat e bëra nga dy fondet burimore të ndryshme;
- Analizimi i kornizës ligjore rregulluese, marrëveshjes përkatëse në mes QRK-së, MAPL-së dhe SDC-së;
- Analizimi i dosjeve të prokurimit dhe krahasimi i tyre me procedurat e Prokurimit Publik në fuqi;
- Krahاسimi i pagesave me realizueshmërinë e punëve për projektet e vitit 2021;
- Analizimi i kërkesave dhe planifikimit të komunës për investime kapitale dhe krahasimi i tyre me projektet e realizuara;
- Intervistimi i zyrtarëve përgjegjës rreth procesit të prioritizimit të investimit në projektet konkrete, të matjes së performancës së komunave, menaxhimit të projekteve;
- Krahاسimi i kërkesave të qytetarëve (grupeve të marginalizuara) me listën e projekteve në të cilat është investuar;
- Ekzaminim fizik i projekteve të realizuara dhe analizimi në qoftë se projektet e realizuara ofrojnë qasje edhe për grupet e marginalizuara;
- Realizimi i anketës përmes zyreve përfaqësuese për grupet e marginalizuara mbi integrimin e tyre në komunitet dhe këto projekte
- Përpilimi i pyetësorve për integrimin e grupeve të marginalizuara në procese të vendimmarrjes dërguar 21 Komunave si alokuese të GPK-së në vitin 2021.

Shtojcat II Komunitet e audituara për vitin 2021 dhe buxheti i ndarë për projekt nga secili fond

Komuna	Projekti	Vlera e audituar	Komuna	Donatorët	Tjetër/ Ministria
Drenas	Rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve në Komunën e Drenasit LOT I -III	388,050	238,050	150,000	NA
Lipjan	Ndriqimi publik në Ribar të Madh	85,631	17,614	74,953	NA
	Ndriqimi Publik në Kraishtë	67,345	6,769	60,000	NA
Vushtri	Ndërtimi i trotuarit në fshatin Stanoc i Epërm	38,911	155	38,757	NA
Skenderaj	Shijoni qytetin në këmbë në rrugën Ilaz Kodra në Skënderaj/ Srbica	149,390	50,000	50,000	50,000
	Ndërtimi i një kopshti - Faza II (Skenderaj/ Srbica)	163,467	50,000	40,000	80,000
Mitrovica e Jugut	Grantet e pashpenzuara	324,073	NA	NA	NA
Leposaviq		64,362		NA	NA
Shterpc		3,449	NA	NA	NA
Prizren	Kthimi i fondit të donacionit	140,966	NA	140,699	NA
Pejë		18,750	NA	18,750	NA

Shënim: Shumat janë në euro.

Shtojca III Anketa me qytetarët

Anketa e përpiluar për qytetarët të cilat i kemi shpërndarë për projektet e realizuara në komunat Lipjan, Vushtri dhe Drenas (projekti i përfunduar 90%). Në këto tri komuna gjithsej janë anketuar/intervistuar 29 qytetarë të rastit.

1. A ka qenë kërkesë e juaja si banorë të fshatit/lagjes ky projekt?

Po

Jo

Tjetër: _____

2. Sa jeni të kënaqur me investimin nga komuna në këtë projekt?

Shumë të kënaqur

Mesatarisht të kënaqur

Aspak të kënaqur

Tjetër _____

3. Sa keni arritur ta shfrytëzoni investimin/projektin ?

Shumë të kënaqur

Mesatarisht të kënaqur

Aspak të kënaqur

Tjetër _____

4. Sa ka ndikuar projekti në përmirësimin e kushteve të banorëve?

Shumë të kënaqur

Mesatarisht të kënaqur

Aspak të kënaqur

Tjetër _____

5. A keni qenë të informuar nga komuna lidhur me investimin në këtë projekt?

Po

Jo

Tjetër: _____

6. Komenti juaj lidhur me investimin kapital gjatë vitit 2021?

Shtojca IV Pyetësi për komunat përfituese 2021

Pyetësor për Komuna - Informata mbi përfshirjen e grupeve të marginalizuara në projektet e financuara nga granti i performancës komunale të dërguar tek 21 Komuna ku 19 prej tyre na janë përgjigjur.

Pyetje	Përgjigje		Komente dhe sqarime shtesë	D o k u m e n t i / Dëshmia
	Po	Jo		
1.Sa janë të përfshirë grupet e marginalizuara në politikat/strategjitë e komunës				
A ka komuna juaj politikë për integrimin e grupeve të marginalizuara?				
A është pjesë e strategjisë së komunës lehtësimi i përditshmërisë dhe integrimi i grupeve të marginalizuara në shoqëri?				
A keni ndonjë adresë/koordinator në komunë, ku mund të drejtohen grupet e marginalizuara me kërkesat e tyre?				
2. Integrimi I grupeve të marginalizuara në komunitet				
Sa keni bashkëpunim me OJQ të cilat merren me grupet e marginalizuara?				
A siguron komuna ndonjë lehtësi për personat që cilësohen si pjesë të grupeve të marginalizuara?				
3.Integrimi i grupeve të marginalizuara në vendimmarrje për investime në projekte kapitale				
A merren për bazë kërkesat e këtyre grupeve kur vendoset të realizohet ndonjë investim kapital? Nëse po, ju lutem nëse mund të listoni emrat e projekteve dhe vitet kur janë realizuar këto projekte?				

A ftohen dhe si ftohen këto grupe në tubimet publike/dëgjime publike? Dhe sa është interesimi i tyre për të kontribuar?				
4.Vlerësimi i përgjithshëm i performancës së komunës në ngritjen e vetëdijes së administratës publike				
A keni bërë ndonjë analizë për këto grupe se sa të kënaqur janë me punën e komunës karshi nevojave të tyre dhe investimet e realizuara?				

Shtojca V Letër Konfirmimet dhe komentet



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MINISTARSTVO ADMINSTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin "Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale"

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin "Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale" (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Elbert Krasniqi,

Data: 29.12.2022

Ministër i MAPL-së



Komuna e Lipjanit

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin "Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale"

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin "Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale" (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin “Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale”

Për: **Zyrën e Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin “Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale” (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetar i Komunës

Bedri HAMZA

Data: 28.12.2022





Komuna e Pejës
Municipality of Peja
Opština Peć

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin “Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale”

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin “Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale” (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.


Gazmend MUHAXHERI
Kryetar i Komunës së Pejës

Data: 10/01/23





PISMO POTVRDE

Za uskladenost sa nalazima Generalnog Revizora za izveštaj „Projekti finansirani iz granta za performanse opštine“

Za: Državna revizorska služba

Postovani,

Ovim pismom potvrđujem da:

- Dobio sam nacrt izveštaja Nacionalne kancelarije za reviziju „Projekti finansirani iz granta za performanse opštine“ (u daljem tekstu „Izveštaj“);
- Slažem se sa nalazima i preporukama i nemam komentara na sadržaj Izveštaja; i
- u roku od 30 dana od prijema konačnog izveštaja, dostaviću akcioni plan za sprovođenje preporuka, koji će sadržati rokove i osoblje odgovorno za njihovu implementaciju.

g. Dalibor Jevtić

Gradonačelnik Opštine,

Datum: 23.01.2023, Štrpce



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Skenderaj
Skupština Opštine Skenderaj
Skenderaj Municipal Assembly

Zyra e Kryetarit /Kabinet Prëdcednika / Office of the Mayor

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin “Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale”

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:


- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin “Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale” (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari i Komunës së Skenderajt

z. Fadil Nura



Data: 06.01.2023



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republik of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri
Kryetari – Predsednik – Mayor

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin “Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale”

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin “Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale” (në tekstin e mëtejme “Raporti”);

pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe

brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

**REPUBLIKA E KOSOVËS****Komuna e Drenasit****Drenas, nr. 01-400/01-4748****Dt. 24.1.2023**

Nga: Ramiz Lladrovci - Kryetar i Komunës së Drenasit

Për: Vlora Spanca - Drejtoreshë e ZKA-së

Kopje:

Fatlinda Ramosaj - Drejtoreshë e Departamentit të Auditimit

Laureta Matoshi Pozhegu – Udhëheqëse e ekipit të Auditimit

Lënda:


Komentet në Draft Raportin e Auditimit të Performancës

Kemi kënaqësinë që përmes kësaj shkrese t'ju përcjellim Komentet tona në lidhje me Draft Raportin Tuaj për Auditimin e Performancës.

Me nderime,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Auditimi i kryer: Auditimi i Performancës

Dokumenti: Komentet nga Komuna e Drenasit ndaj Draft raportit të auditimit

Gjetjet	Pajtohem po/ jo	Komentet nga Institucioni i audituar në raste të mospajtimit	Pikëpamja e ZKA-së
Ndarja e projektit në Lote	Jo	Arsyet e ndarjes së projektit në Lote, ne i kemi përcjellë tek Ju, përmes shkresës nr. 01-052/01-1403 të dt. 6.1.2023. Komentet i kemi shoqëruar edhe me dokumentet përkatëse: Dok. nr. 1. (Ligji nr. 05/L-068); Dok. Nr. 2. (Shkresa me nr. 03-400-23429, e dt. 3.6.2021); Dok. Nr. 3. (RUOPP), dhe Dok. nr. 4. (Tabela e kalkulimit për përzgjedhjen e fituesve sipas Loteve). Për arsyet e cekura, ne kemi vepruar konform ligjit, pra, nuk ka pasur mundësi të kursimit financiar, kemi implemtuar metodat më të mira të mundshme dhe kemi shmangur çuarjen dëm të projektit. Evidentimi në Draft se ne “do të kishim mundur të kursenim një shumë prej 106.546 €”, është supozim që nuk merr për bazë rrethanat ligjore të shpalljes së tenderit, si dhe nuk merren parasysh paramasat e ndryshme të tri Loteve (janë paraqitur në e mail, më 23.1.2023). Me këtë projekt, kemi përmirësuar maksimalisht cilësinë e shërbimeve publike.	Siç është cekur në raportin e auditimit, aktiviteti i prokurimit për projektin në fjalë është në përputhjen me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, ndër parimet bazë të LPP-së janë ekonomia dhe efikasiteti. Prandaj, sikur procedura mos të ishte ndarë në LOT-e dhe sasisë e realizuara nga tre LOT-et të ishin blerë me çmimet e ofertuesit më të lirë të përgjegjshëm, Komuna do të kursente buxhet. Rrjedhimisht, ndarja e tenderit në LOT-e në rastin konkret ka rezultuar jo ekonomike.

Mungesa e Projektit ekzekutiv	Pjesërisht	Meqë projekti “Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit”, nuk ishte projekt i ri, por “rehabilitim i rrjetit ekzistues”, nuk kemi pasur mundësi që ta sigurojmë projektin ekzekutues. Paraprakisht nuk ishte e ditur se ku do të paraqitet nevoja e rehabilitimit.	Projekti ekzekutiv është një kërkesë e caktuar me legjislacionin në fuqi. Neni 20.10 i RrUOP thotë se: Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutues ndërsa neni 20.13 thotë se: Projekti Ekzekutues është një dizajn grafik i të gjitha proceseve administrative dhe inxhinjerie, të punimeve të kërkuara siç është përshkruar në specifika teknike dhe prandaj, parashtron, në raste të veçanta, punime arkitektonike, strukturore të punëve që do të ekzekutohen. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatorë duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) specifikat teknike të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoritet Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.
Mosevidenti i vendpunishtes	Pjesërisht	Vend punishtet nuk kanë mundur të përcaktohen më herët për shkak të natyrës së projektit, kushteve atmosferike dhe avarive të tjera që shkaktohen nga faktorët e ndryshëm. Vend punishtet janë evidentuar gjatë implementimit të projektit, sipas kërkesave të qytetarëve (administratorëve të fshatrave), të cilat më 6.1.2023 ua kemi dërguar (Dok. nr. 5). Pas çdo intervenimi, janë bërë edhe matjet gjeodezike të vendpunishtes ku janë kryer punët dhe me shkresën nr. 01-052/01-1403, ua kemi dërguar edhe Dok. nr. 6, ku shihen incizimet gjeodezike.	Neni 20.11 i RrUOP thekson se: Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të tregojnë b) një përshkrim të përgjithësuar të vend punimit dhe/ose ndërtesës (lokacionit, madhësisë, sasisë së pjesëve të ndërtesës, elementet strukturore, instalimet ekzistuese, etj) dhe synimi i fushëveprimit të vend punimit/ndërtesës. Dosja e tenderit për procedurën në fjalë nuk e kishte plotësuar këtë kërkesë.



Zyra Kombëtare e Auditimit | Lagjja Arbëria | Rr. Ahmet Krasniqi, 210 | 10000 Prishtina
Republika e Kosovës